

Nga Dr. Rudina Thanasi

Mezoterapia, procedura e rinimit pa dhimbje dhe efekte anësore

Mos e humbni këtë intervistë speciale të Dr. Rudina Thanasit, e cila përveçse dermatologe, Venerologe, Dermatologe, Kozmetologe, është edhe autore mjekësore dhe Kërkuese Shkencore

Mezoterapia është një specialitet mjekësor që përfshin injektimin e individualizuar dhe të përshtatur sipas kushteve mjekësore të pacientit, të substancave homeopate, natyrale, vitaminoze, minerale dhe farmaceutike në sasi mikroskopike në lëkurë, me efekt vetëm lokal.

MUND TË PËRDORËT PËR eliminimin e celulitit, nxitjen e përshpejtuar të dobësimin, rinimin e lëkurës dhe duarve, rimodelim trupor trajtimin e lëkurës së varur trajtimin e lëkurës së trashur trajtimin e lëkurës dyfishe, trajtimin e dhimbjes post-Zosteriane, gushës dyfishe, lipomave, mialgjive, dhimbje osteo-artikulare, etj.

- Fjala mezoterapi vjen nga greqishtja e vjetër dhe do të thotë trajtim në mesodermë; është një sinonim i kohës i përdorur për trajtim mjekësor. Edhe vetë injektimi me botulinium toksinë për relaksim, trajtimi i hiperhidrozës apo trajtimi me acid hialuronik për hidratim, ristrukturues, jovoluminoz, është pjesë e specialitetit të mezoterapisë.

Çfarë duhet të pres në vizitën e parë për mezoterapinë dhe vazhdimin në takimin e mëtejshëm?

Vizita e parë me Dr. Rudina Thanasin do të jetë një konsultë mezoterapie. Bëhet një historik i detajuar mjekësor, si dhe shpjegime të detajuara se çfarë është mezoterapia.

Ju rekomandohen disa analiza standard apo të detajuara, sipas rastit individual. Doktorësia do të dëgjojë me shumë vëmendje çdo shqetësim tuajin.

Pas kësaj, bëhen disa fotografi për të ndjekur ecurinë e trajtimit në vazhdim. Po ashtu, ju bëhen dhe dy injeksione të vogla për të parë nëse jeni alergjikë nga ndonjë substancë.

I kërkohet pacientit të bëjë një telefonatë pas 24 orësh, për të kontrolluar nëse ka ndonjë reagim alergjik apo jo.

Zakonisht pacientët nuk fillojnë trajtimin në të njëjtën ditë me konsultën, për të parë nëse kanë reaksion alergjik.

Si rregull, trajtimi fillon pas 2 ditësh deri në 2 javë, për t'iu përshtatur sa më mirë nevojave dhe sigurisë së shëndetit të pacientit.

Pacienti zakonisht lë një takim më parë për t'iu përshtatur sa më mirë orarit të tij. Duhet të vihet një herë në javë, por edhe

nëse ndonjë trajtim nuk bëhet në kohën e duhur, kjo nuk ndikon në progresin e përgjithshëm.

Kur do t'i shoh rezultatet?

Rezultatet varen nga lloji i trupit dhe kushtet që po trajtoni... Mesatarisht pacienti fillon të shikojë rezultate në seancën e dytë dhe të tretë. Në disa kushte, shikon rezultate qysh në seancën e parë.

A do të zgjasin rezultatet?

Rezultati zgjat në veçanti kur kombinohet me sport dhe me dietën e duhur, duke u ruajtur nga dielli, etj., me rekomandime dhe këshilla që i jepen çdo pacienti më vete në varësi të nevojave të tij. Megjithatë, ne nuk mund të ndalojmë procesin tuaj të natyrshëm dhe individual të plakjes. Prandaj rekomandojmë vizita të rregullta mirëmbajtjeje. Për të ndihmuar pacientin dhe për të respektuar investimin e tij, i rekomandojmë po ashtu këshilla për ëllbeing dhe rregullim të ciklit circadian të individualizuar

A janë të dhimbshme trajtimet?

Ju mund të ndjeni një pickim të lehtë ose ndonjë ndjesi djegieje gjatë kohës që ndodh trajtimi. Për ata që janë të ndjeshëm rekomandojmë dhe ofrojmë krem anestetik lokal.

A ka efekte anësore të mundshme mezoterapia?

Efekt anësor i zakonshëm është enjtja, nxirja dhe në rastin e depozitave të dhjamit, edhe një ndjesi rëndese. Këto efekte zakonisht mbajnë deri në një javë. Për të përshpejtuar procesin e shërimit rekomandojmë tableta nga goja apo aplikim kremi local me arnica përditë. Pacienti mund të ndjejë edhe dhimbje në prekje, por kjo zakonisht zbehet në 24-48 orë.

A ka ndonjë kufizim?

"Mezoterapia është një ndër procedurat shumë të kërkuara, sepse është e sigurt, nuk shkakton dhembje dhe është efektive për rinimin e lëkurës, eliminimin e rrudhave dhe gropave të syve, deri te ekskluzivisht problemet mjekësore."



Kufizimet variojnë nga kushtet që po trajtohen. Ne i bisedojmë këto gjëra në detaje me çdo pacient, në veçanti përpara fillimit të trajtimit. Si rregull i përgjithshëm, i rekomandohet pacientit të mos përdorë make-up për 4-6 orë pas trajtimit, të mos bëjë dush me ujë të nxehtë për 6-8 orë pas trajtimit, të hajë dieta të pasura me pro-

teina dhe të mos konsumojë kafe apo substanca stimuluese përpara trajtimit.

Sa kushton mezoterapia?

Kostoja është në bazë të kushteve të trajtuara dhe seancave të nevojshme për të mbërritur rezultatin e dëshiruar. Përpara trajtimit, i shpjegohen të gjitha këto hollësi pacientit dhe bëhet një plan paraprak.

Kush duhet t'iu nënshtrohet mezoterapisë?

Mezoterapia aplikohet te: reduktimi i rrudhave dhe parandalimi e shfaqjes së rrudhave të reja në fytyrë, qafë dhe dekolte; tendosja e lëkurës së lëshuar të fytyrës, qafës dhe dekoltesë; hidratimi intensiv dhe i thellë i lëkurës; ruajtja e balancës së mirë biologjike; ngritja e tonusit dhe elasticiteti i lëkurës; reduktimi i vragave nga aknet, si edhe vragave të natyrës tjetër; eliminimin e pigmenteve nga lëkura; trajtimi i gropave të errëta të syve; terapia te aknet dhe e poreve të zgjeruara; rinimi i lëkurës së shuplakave; tendosja e lëkurës së lëshuar në qepalla, stomakut; transformimi i trupit; reduktimi i strijave; rënia e flokëve; forcimi, hidratimi dhe nxitja e rritjes së flokëve, rigjenerimi i lëkurës së kokës etj.

- Indikacion tjetër i rëndësishëm për mezoterapinë është reduk-



timi i celulitit. Atëherë përdoren substanca të cilat shkrijnë yndyrën, forcojnë qarkullimin e gjakut, mundësojnë drenazhin më të mirë ose kanë ndikim diuretik.

INTOLERANCA USHQIMORE

Dr. Rudina Thanasi: Mjaft u mbushe plot me ilaçe, por bëje Testin e Intolerancës Ushqimore


Shumë njerëz e kalojnë jetën e tyre pa e mësuar kurrë se intolerancat ushqimore janë shkaku kryesor i shëndetit të tyre të keq, apo që nuk bien dot nga pesha sado që mbajnë dieta. Çuditërisht, janë të njohura alergjitë ushqimore, por dihet pak mbi intolerancat ushqimore. Edhe pse, në fakt të pasurit e një intolerance ushqimore është shumë më e zakonshme se një alergji ushqimore. Njerëzit që ndihen keq bëjnë qindra analiza e teste, përfshirë atë të alergjisë, por nuk e dinë se: Ajo që u duhet është pikërisht Testi i Intolerancës Ushqimore. Shpesh, ky test është zgjidhja e problemeve shëndetësore në mënyrë natyrale, pa u "furnizuar" me ilaçe. Por, për të na e shpjeguar më mirë se çfarë është Intoleranca Ushqimore dhe ku ndryshon me alergjinë, gazeta "Super Shëndeti" ka intervistuar Dr. Rudina Thanasi, që ka titujt më të lartë si doktoreshë dhe është autore mjekësore dhe Kërkuese Shkencore... Dobësohu në mënyrë natyrale dhe zgjidh problemet me shëndetin, me Testin e Intolerancës Ushqimore!

Dr. Rudina, për të gjithë ata që nuk e dinë, çfarë është Intoleranca ushqimore?

Intoleranca ushqimore është një reagim kronik i organizmit ndaj ushqimeve që konsumohen më shpesh, por ndonjëherë ke intolerancë edhe ndaj atyre që i ke konsumuar shumë rrallë. Ti mund ta hash sa të duash gjëra të shëndetshme, por trupi nuk ta njeh si ushqim, por si "trup të huaj". Për shembull, ti mund të hash sallatë jeshile sa të duash, të pish edhe limon esëll me mëngjes dhe sërish nuk bie nga pesha; madje edhe shton peshë. Ose një shembull tjetër, psh diabetikët mund të mbajnë një dietë me indeks të ulët glicemik dhe sërish ta kenë luhajtje të sheqerit në gjak. Kjo ndodh sepse në dietë janë përfshirë ushqime që janë të mira për diabetikët, por ti mund të kesh intolerancë të ndonjë prej këtyre. Kështu që, kot sa mban dietë. E njëjta gjë ndodh edhe për probleme të tjera shëndetësore: Nuk mund të mbash një dietë korrekte, pa e ditur se cilat ushqime nuk t'i pranon trupi, nuk t'i toleron, pra nuk t'i tret. Si rezultat, mund të kesh fryrje barku, dhimbje koke, luhajtje tensioni, lodhje të pashpjegueshme, nervozizëm, luhajtje të mëdha humori, pagjumësi, probleme stomaku etj. E gjitha kjo, sepse disa ushqime nuk metabolizohen në mënyrë korrekte dhe kështu "bllokojnë" organizmin tonë.

Ku ndryshon intoleranca ushqimore nga alergjia ushqimore?

Në rastin e intolerancës ushqimore, simptomat nuk shfaqen menjëherë pas marrjes së ushqimit, si në rastin e alergjive. Nëse te alergjia e kupton direkt se diçka të ka bërë keq dhe të shfaq shenja të dukshme, në rastin e intolerancës ushqimore ndonjëherë e kupton se diçka nuk shkon mirë me organizmin, por nuk e shpjegon dot pse. Bën plot analiza dhe të dalin mirë. Mban dietë dhe nuk bie në peshë. Mbushesh me ilaçe dhe sërish nuk shërohet. Në fakt, problemi nuk



Dr. Rudina Thanasi: Dobësohu me Testin e Intolerancës Ushqimore

është se ke një sëmundje reale, por ke vetëm intolerancë ushqimore. Pra, ke disa ushqime që të çojnë në këtë gjendje dhe thjesht duhen mënjanuar ato ushqime, nuk është nevoja të eksperimentosh me ilaçe apo dieta ekstreme.

Përmendët disa probleme që shfaqen nga intolerancat ushqimore, po disa shenja të tjera, si mund ta kuptojmë?

Intoleranca ushqimore mund të paraqitet në formën e shqetësimeve gastrointestinale (stomak i fryrë, nausea, diarre), çrregullimeve dermatologjike (dermatit, ulçera të gojës) ose inflamacion. Ka një tendencë që të marrësh peshë dhe të mos biesh dot, edhe pse mban dietë. Gjithashtu, intoleranca mund të shfaqet me marrje mendsh, dhimbje koke, lodhje kronike, pagjumësi, si edhe luhajtje humori që mund të shkojnë deri në depresion. Simptomat dhe ndryshimet mund të shfaqen tek çdo organ ose sistem, duke implikuar funksionet e tyre. E vërteta është se çdo simptomë mund të ketë si shkak intolerancën ushqimore. Disa nga këto simptoma janë:

- Ekzema, akne, lëkurë e thatë dhe psoriasis.
- Gazra, fryrje, diarre, konstipacion dhe refluks
- Dhimbje koke dhe migrenë.
- Lodhje kronike, përgjumje apo pagjumësi.
- Alergjitë sezonale dhe astma.
- Vështirësia në përqendrim.
- Dhimbje muskujsh dhe kockash.
- Ankth dhe depresion.

Të gjitha problemet e mësipërme, mund të përmirësohen me realizimin e testit të intolerancës ushqimore në ADN, që tashmë,

për herë të parë mund të realizohet edhe në Tiranë përmes fijeve të flokut.

Cilat janë prioritetet e një intolerance ushqimore apo analizave të tjera përmes fijeve të flokut, në krahasim me një analizë gjaku apo analizë urine?

Testimi i rrënjës së flokëve, bën analizën direkt në ADN, pra zbulon problemin që në gen. Si asnjë test apo analizë tjetër, përmes rrënjës së flokut gjenden jo vetëm ushqimet që ju sjellin intolerancë, por zbulohen edhe mungesën që një pacient ka në vitamina, minerale, antioksidantë, aminoacide, acidet yndyrore; për 800 elementë. Gjithashtu përmes testimit të flokëve zbulohet nëse organizmi ka toksina, metale të rënda toksike, myk, parazitë, kërpudha, viruse dhe postviruse, e deri te rrezatimet e telefonit, ekranit të TV, mikrovalës etj. Ky test i i flokëve gjithashtu mat 6 raporte të rëndësishme dhe shkallën e oksidimit të trupit. Të gjitha këto, e bëjnë Testin e Intolerancës ushqimore superior, krahasuar me teste të tjera gjaku, urine etj. Ndërkaq, testi i intolerancës ushqimore me flokë nuk jep asnjë dhimbje, nuk ka nevojë që të mos ushqehesh më parë, nuk ka rëndësi nëse ke marrë ilaçe, pra nuk duhet asnjë lloj parapërgatitje. Tejet i thjeshtë për t'u realizuar, vetëm duke marrë 3-4 fije floku me rrënjë, nga pjesa e pasme e kokës, që analizohen në laborator të specializuar.

Pas realizimit të testit, çfarë ndodh?

Vjen përgjigjia për të gjitha ato që thashë më lart. Pra, të zbulohen ushqimet që i bëjnë dëm trupit, mënjanohen të gjitha ato. Krijohet një regjim ushqimor me ushqime të tjera

që i bëjnë mirë organizmit dhe që plotësojnë mungesat ushqimore për vitamina, minerale, etj, që kanë dalë mangut në pasqyrën klinike të testit. Pra, përmirësohet shëndeti apo zgjidhet problemi i peshës vetëm përmes ushqimit. Po kështu, me anë të kësaj analize ju mund të zbuloni edhe sëmundjet që kanë shkak intolerancën ushqimore.

A është e detyrueshme që të bëhet intoleranca ushqimore?

Asgjë nuk është e detyrueshme, por është e këshillueshme. Në spitalet europiane apo perëndimore, testi intolerancës ushqimore sugjerohet shpesh edhe në analizat bazë që duhet të bëjë çdokush. Ose, dietologët dhe nutricionistët e rekomandojnë këtë test patjetër, para se t'u japin pacientëve një dietë, në mënyrë që të kenë efikasitet 100 % dhe mos t'i mbushin me ushqime që nuk ua pranon trupi. Mjekësia ka avancuar dhe duke qenë se Testi i Intolerancës Ushqimore është një opsion serioz që çon në përmirësimin e shëndetit, duhet të sugjerohet. Njerëzit duhet ta dinë që ekziston ky opsion për të rënë në peshë në mënyrë natyrale dhe për të përmirësuar shëndetin, pastaj gjithsecili është i lirë të bëjë zgjidhjen e vet.

A ka një moshë limit se kush mund ta bëjë dhe kush jo?

JO, nuk ka asnjë moshë limit. Që nga fëmijët nga lindja dhe deri te të moshuarit, që Zoti i bëftë të jetojnë sa më gjatë. Gjithashtu është e këshillueshme që ta bëjnë edhe gratë shtatzana, që mos të hanë në mënyrë të gabuar dhe kështu ta ruajnë fetusin në mënyrë maksimale. Po ashtu, do t'ju dalin vitaminat dhe mineralet që u mungojnë në trup, në mënyrë që t'i kompesojnë. Tejet e rekomandueshme është ky test edhe për pacientë që kanë kaluar operacione apo që kanë probleme shëndetësore të rënda, sepse duke gjetur ushqimet që nuk ua pranon trupi, i ndihmon që të rimirin veten shpejt. Pra, është një analizë që duhet ta bëjë e gjithë familja, i shëndetshëm apo sëmurë qoftë! Një test që përmbledh shumë analiza brenda, nuk ke nevojë të bësh "100 analiza" shëndetësore, kur bën vetëm Testin e Intolerancës Ushqimore.

PRENOTONI TESTIN E INTOLERANCËS USHQIMORE OFERTA

Oferta 25 % deri në fund të Dhjetorit: Ishte 200 euro, e prenotoni me 150 euro CEL: 069 88 17 187

Bëni testin e intolerancës për këto sëmundje

- Jeni mbipeshë?
- Keni dhimbje barku?
- Probleme të tretjes?
- Djegie dhe fryrje stomaku?
- Gastrite?
- Dhimbje kronike të kokës?
- Ankth, stres, depresion?
- Lodhje kronike?
- Mungesë përqendrimi?
- Alergji të lëkurës, Sinusit?
- Çrregullime në jashtëqitje?
- Probleme hormonale?
- Fryrje të këmbëve dhe duarve?
- Anemia?
- Jeni shtatzanë ose kërkoni të mbesni shtatzanë dhe dëshironi fëmijë pa defekte gjenetike?
- Keni probleme menopauze?
- Probleme me sëmundjet reumatizmale
- etj?
- * Bëj Testin e Intolerancës Ushqimore, zgjidh SAKTE problemin e shëndetit tëm

me Ushqim

* Nëpërmjet Testit të Intolerancës Ushqimore në ADN kontrollohen 600 lloje ushqimesh dhe 200 minerale, aminoacidet, radiacionet, valët e celularit, vitamina apo ndotësish ambjentalë, të shoqëruar me dietën përkatëse të personalizuar.

SHENIM

Oferta 25 % deri në fund të Dhjetorit: Ishte 200 euro, e prenotoni me 150 euro PËR PRENOTIM: 069 88 17 187